



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 322 Prot.

Lezhë, më 10.03.2025

### URDHËR

Nr. 156 Datë 10 . 03 .2025

#### **“PËR MIRATIMIN E POZICIONEVE TË KATEGORISË SË ULËT DHE TË MESME DREJTUESE TË CILAT DO TË JENË TË HAPURA PËR KONKURIM DHE PËR PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, NË BASHKINË LEZHË”**

Në zbatim të nenit 26, pika 4 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Urdhërit nr.3 datë 06.01.2025 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë , të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2025”, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.153 datë 04.03.2025, “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2025”,

#### **URDHËROJ:**

1. Të lejoj që procedura e plotësimit të vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese të jetë i hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për këto vende, për pozicionet si më poshtë:

##### **A. Të kategorisë së mesme drejtuese:**

- Drejtor, Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, në Bashkinë Lezhë, Kategoria II-2.
- Drejtor, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, në Bashkinë Lezhë, Kategoria II-2.
- Drejtor, Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës, në Bashkinë Lezhë, Kategoria II-2.

##### **B. Të kategorisë së ulët drejtuese:**

- Përgjegjës Sektori, Sektori i Administrimit dhe Mbrojtjes së Pronave, Drejtoria e Administrimit të Aseteve dhe Kadastrës, në Bashkinë Lezhë, Kategoria III-2.
  - Përgjegjës Sektori, Sektori i Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore, në Bashkinë Lezhë, Kategoria III-2.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Bashkisë Lezhë.
  3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Pjerin Ndreu**

